

URDHËR
Nr. 551, datë 25.10.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të shkronjës “r”, të nenit 10, të vendimit nr. 124, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kapitullit 2, “Rregullore e përshkrimeve të punës”, pika 4 dhe të nënkapitullit III, “Zëvendës drejtorët e përgjithshëm”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës së Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, znj. Anila Minxhozi, me detyrë zëvendës drejtor i përgjithshëm, për ndjekjen e mbarrëvajtjes së punës së Drejtorisë së Kontrollit, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe objektivave institucionale.

2. Drejtoria e Kontrollit të jetë në varësi direkte të znj. Anila Minxhozi, zëvendës drejtor i përgjithshëm.

3. Zëvendës drejtori i përgjithshëm të mbikëqyrë dhe të nënshkruajë aktet administrative të kësaj Drejtorie, në lidhje me zbatimin e detyrave të përcaktuara në rregulloren “Për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës së Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”, për Drejtorinë e Kontrollit.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Anila Minxhozi, zëvendës drejtor i përgjithshëm, si dhe të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Kontrollit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Anila Denaj